

**Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

Faqe

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

4

PASQYRA E BURIMEVE DHE E PËRDORIMIT TË FONDEVE

5

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

6

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

7-16



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin dhe Këshillit Drejtues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar :

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, IEKA, që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën individuale të burimeve dhe perdorimeve të fondeve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 7 deri në faqen 16.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të IEKA. më 31 dhjetor 2018 si dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të cilat janë bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe vecanërisht Standartin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga IEKA në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë si dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të modifikuar.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) për OJF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së IEKA për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të IEKA.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të njafueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijmësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijmësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Montenegro | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijëmbësi.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e IEKA, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 13 Maj 2019


Laura Gjinali, Auditues Ligjor



Rajmonda Revell, Auditues Ligjor




Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2018	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2017
AKTIVE			
Aktive Afatshkurtëra			
Mjete monetare	4	70,527,386	78,209,331
Llogari të arkëtueshme	5	4,711,885	4,512,351
Inventarët	6	326,093	351,112
Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)	7	6,118,128	3,620,165
Shpenzime të periudhave të ardhëshme	11		
Totali i Aktiveve Afatshkurtëra		81,683,492	86,692,959
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	35,965,723	38,134,524
Aktive afatgjata jomateriale			
Totali i Aktiveve Afatgjata		35,965,723	38,134,524
TOTALI I AKTIVEVE		117,649,215	124,827,483
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	9	4,546,110	9,369,651
Detyrime të tjera (kuota variabël, etj)	7	443,777	618,789
Detyrime tatimore	10	318,712	386,616
Të ardhura të periudhave të ardhme	11	1,155,866	1,202,466
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		6,464,465	11,577,522
Totali i Detyrimeve		6,464,465	11,577,522
AKTIVET NETO	12	111,184,750	113,249,961

Shënimet nga faqja 7 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr.7, datë 19.04.2019 dhe nënshkruar në emër të tij nga:


Elvira HOXHA
 Drejtor Ekzekutiv


Alida Daija
 Sektori i Financë Kontabilitetit



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e burimit të fondeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

		Ushtrimi i mbyllur 31.12.2018	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2017
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtaria kryesore	13	24,019,631	27,932,692
i. Kuotat e anëtarësimit të AL, shoqërive, kandidatëve		23,549,513	26,961,025
ii. Të ardhura të tjera		470,118	971,667
Burimet nga kualifikimi i ALve & kandidatë	15	2,602,500	2,255,500
Burimet nga publikimet	16	135,220	11,000
Sponsorizime (Konferenca 20 Vjetori)			1,098,812
Totali i burimeve - të ardhurave		26,757,351	31,298,004
PERDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore	14	(22,135,134)	(26,672,313)
Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit		(5,467,317)	(5,592,610)
Honorare të Drejtimit, Komitete etj		(5,175,880)	(5,109,724)
Shpenzime administrative dhe të tjera		(11,491,937)	(11,263,772)
Shpenzime për 20 vjetorin e IEKA		-	(4,706,207)
Shpenzime kualifikimi i ALve & kandidatëve	15	(3,022,416)	(2,904,514)
Shpenzime për botime	16	(55,019)	(132,517)
Totali i përdorimit të fondeve		(25,212,569)	(29,709,344)
		1,544,782	1,588,660
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore	-		
Humbje nga kursi i këmbimi		(102,449)	72,888
Të ardhura nga interesat		351,285	378,652
Të ardhura (shpenzime) financiare		248,836	451,540
Aktiviteti sipas vendimit të Asamblesë		(3,858,829)	
Teprica/deficit i burimeve për vitin financiar	17	(2,065,211)	2,040,200
Aktivitet neto në fillim të vitit		113,249,961	111,209,761
Aktivitet neto në fund të vitit		111,184,750	113,249,961

Shënimet nga 7 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2018	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2017
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Përdorime të fondeve për vitin	(2,065,211)	2,040,200
Rregullime për:		
Amortizimin	2,168,801	2,013,218
Nxjerrje jashtë përdorimit të AAM		
Efekti i ndryshimit në politikën kontabël		
Rritje/rënie në aktivet afatshkurtëra	(2,672,478)	(638,749)
Rritje/rënie në detyrimet afatshkurtëra	(5,113,058)	(2,725,879)
Rrjedha e parasë e përfituar nga aktivitetet e shfrytëzimit	(7,681,946)	688,790
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-	(991,461)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	-	(991,461)
Rrjedha neto e parasë	(7,681,946)	(302,671)
Mjetet monetare në fillim të vitit (shënimi 4)	78,209,332	78,512,003
Mjetet monetare në fund të vitit (shënimi 4)	70,527,386	78,209,332

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë "IEKA" ose "Instituti"), është një shoqatë profesionale që grupon Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (të ndryshuar), si dhe me Ligjin për "Organizatat jo-fitimprurëse" dhe me statutin e tij.

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Audituesit Ligjor vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në "Rruga e Elbasanit", pallati Edil AI - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKA si dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo-fitimprurëse (SKK për OJF) në fuqi nga 1 Janar 2016.

Politikat kontabël si më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Ndryshim i politikës kontabile për njohjen e të ardhurave nga kuota variabile

Mbështetur në vendimin nr. 14, datë 28 dhjetor 2012 të Këshillit Drejtues, në 1 janar 2013 Instituti ndryshoi politikën e njohjes së të ardhurave për kuotën variabël. Sipas këtij vendimi shumat e të drejtave/detyrimeve lidhur me deklaratimet dhe pagesat e kuotës variabël të AL të azhuruara deri më 31 Dhjetor 2015 janë përfshirë në llogaritë përkatëse të AL-ve dhe shoqërive të auditimit.

Në përputhje me politikën e re kontabël të ardhurat nga kuota variabël do të njihen në momentin e deklaratimit të kuotës variabël në shumat e përlllogaritura bazuar në tabelat e misionëve të deklaruara prej AL-ve dhe shoqërive të auditimit dhe pagesat e kryera gjatë vitit do të ulin detyrimin për kuotën variabël të deklaruar e të papaguar.

(d) Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, IEKA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Institutit janë prezantuar në Lekë shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale e Institutit. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Parimet kontabël kryesore të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare janë si më poshtë:

(b) Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë njohur mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, për kuotën fikse vjetore për çdo anëtar dhe për kuotat variabël të llogaritura si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara nga secili anëtar. Shuma e kuotës fikse dhe përqindjes së kuotës variabël janë përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 29 qeshor 2017 (vendimi nr. 126) i cili zbatohet nga 1 janar 2018. Masa e kuotës fikse është 70.000 lekë dhe asaj variabël është 0,5% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale nga 0-8 mln lekë dhe 0.3% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale mbi 8 min lekë, të cilat janë respektivisht si më poshtë:

	2018	2017
Kuota fikse	70,000	100,000
Kuota variabël	0.5% dhe 03%	0.5%

Në burimet e Institutit përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, siç janë publikimet profesionale, nga kualifikimi i vijueshëm dhe nga anëtarët e rinj. Për secilën kategori të këtyre burimeve të fondeve është paraqitur edhe shuma përkatëse e përdorimeve.

Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera për vitin por që nuk janë paguar në fund të vitit.

(c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, ka qënë respektivisht si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
U.S. Dollar (USD)	107.82	111.1
Euro (Euro)	123.42	132,95

(d) Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi më pak se një vit.

(e) Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike. Instituti ka filluar të përlllogarisë vlera të arkëtueshme nga kuotat fikse të anëtarëve vetëm më 31 dhjetor 2012.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale paraqiten me vlerën e tyre historike minus amortizimin e akumuluar. Politika e llogaritjes së zhvlerësimit ka filluar të aplikohet për herë të parë nga 1 janari 2009. Shtesat e aktiveve afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të blerjes të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë aktivin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Amortizimi është llogaritur me metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit, duke aplikuar normat e mëposhtme të amortizimit (sipas IEKA-s):

Kategoria e aktiveve fikse	Normat e amortizimit	
	2018	2017
Ndërtesa	5%	5%
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%

Për vitin 2011, është aplikuar llogaritja e zhvlerësimit për herë të parë për ndërtesat.

(g) Teprica dhe defikiti i burimeve

Teprica / defikiti midis burimeve dhe përdorimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në pasurinë neto të IEKA.

(h) Tatimi mbi fitimin

IEKA është institut jofitimprurës. Si i tillë, Instituti nuk paguan tatim mbi fitimin. Instituti respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

(i) Kontributet për sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Shoqëria paguan kontributet për pensione si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2018	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2017
Paraja në bankë		
Intesa SanPaolo (Lekë)	10,897,816	10,077,371
Intesa SanPaolo (Euro)	266,450	226,865
Intesa SanPaolo (Usd)	9,567	16,524
Shuma ekuivalente në lekë	11,173,833	10,320,760
 Banka Kombëtare Tregtare (Lekë)	2,003,577	316,036
Banka Kombëtare Tregtare (Euro)	2,055,501	560,198
Banka Kombëtare Tregtare-Provimet (Lekë)	35,106	5,783,629
Shuma ekuivalente në lekë	4,094,184	6,659,863
 Raiffeisen Bank (Lekë)	12,156,691	18,363,935
Raiffeisen Bank (Usd)	32,662	40,322
Shuma ekuivalente në lekë	12,189,353	18,404,257
 Depozita me afat	42,726,239	42,419,831
 Totali në Bankë	70,183,609	77,804,711
 Paraja në arkë		
Paraja në Arkë (Lekë)	80,910	162,382
Paraja në Arkë (Lekë)	50,277	148,798
Paraja në Arkë (Euro)	212,590	85,552
Paraja në Arkë (Usd)	-	7,888
Totali në arkë	343,777	404,620
 Totali	70,527,386	78,209,331

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjete monetare (vazhdim)

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit, paraqiten si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2018	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2017
Depozita me afat 12 muaj		
Banka Kombëtare Tregtare	15,873,266	15,739,481
Intesa SanPaolo	7,500,000	7,500,000
Credins Bank	19,352,973	19,180,350
Totali	42,726,239	42,419,831

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 të ardhurat nga interesi janë 351,285 Lekë (31 dhjetor 2017: 378,652 Lekë).

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Përshkrimi		
AL kuotë fikse pjesore dhe penaltitete	2,649,770	2,464,236
AL pasivë kuota fikse	1,786,165	1,786,165
Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar	143,000	129,000
Provizion për kuotat e papaguara	0	0
Detyrime për aktivitete	132,950	132,950
	4,711,885	4,512,351

6. Inventarët janë të përbërë si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Përshkrimi		
Kodi Etikës	910	910
SNA	12,480	52,000
Guida	70,650	70,650
Revista	18,734	18,734
Udhërrëfyese	91,915	93,950
SNA - Raporti i audituesit të pavarur	86,904	100,368
Të tjera	44,500	14,500
Totali	326,093	351,112

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

7. Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)

Të arkëtueshme të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit ndaj anëtarëve të tij në lidhje me kuotën variabël. Këto të drejta lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më pak se misionet e deklaruar. Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 janë 6,118,128 Lekë (31 dhjetor 2017: 3,620,145 Lekë).

Detyrime të tjera përfaqësojnë detyrimet e Institutit ndaj anëtarëve të tij për kuotën variabël. Këto detyrime lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më shumë se misionet e deklaruar. Detyrimet për kuotën variabël më 31 dhjetor 2018 janë 443,777 Lekë (31 dhjetor 2017: 618,789 Lekë).

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Ndërtesa	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje elektronike	Total
Kosto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	47,455,444	3,273,550	10,873,121	61,602,115
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	47,455,444	3,273,550	10,873,121	61,602,115
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	12,339,313	2,100,528	9,027,753	23,467,591
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-
Amortizimi vitit	949,408	654,710	564,683	2,168,801
Gjendja më 31 dhjetor 2018	13,288,721	2,755,238	9,592,436	25,636,392
AAM Vlera Kontabël Neto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	35,116,542	1,173,022	1,845,368	38,134,524
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	34,166,723	518,312	1,280,685	35,965,723

Zëri "Ndërtesa" rezulton me vlerë bruto 47,455,444 Lekë më 31 dhjetor 2018. Është marrë titulli i pronësisë për zyrat e IEKA nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Ato janë konsideruar si aktive afatgjata materiale të IEKA-s.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

9. Llogari të pagueshme dhe detyrime

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Komiteti i Cilësisë	985,000	985,000
Komiteti i Edukimit	40,650	41,950
Komiteti i Kualifikimit të vijueshëm	44,000	44,000
Komiteti i Përkthimit	100,000	100,000
Këshilli i Drejtues	27,000	27,000
Totali	1,196,650	1,197,950
Përshkrimi		
EDIL AL-IT punime të zyrave të reja	178,494	178,494
Detyrime ndaj punonjësve	0	30,351
Geci shpk	436,500	375,000
Të tjera	1,751,449	703,872
Alb Paper	0	49,800
Vitrina Franceze	449,640	
APA-Albpartner	0	49,800
Detyrime ndaj të tretëve	353,377	6,784,384
Avokati	180,000	
Totali	3,349,460	8,171,701
Totali i llogarive të pagueshme	4,546,110	9,369,651

10. Detyrime tatimore

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Shteti tatime taksa (TAP)	238,234	323,129
Sigurime shoqërore	80,478	63,487
	318,712	386,616

10. Të ardhura dhe shpenzime të periudhave të ardhshme

IFAC, IEKA dhe SHKÇAK kanë lidhur një marrëveshje trepalëshe me qëllim uljen e kostove të përkthimit si dhe në kuadër të unifikimit të terminologjisë profesionale me fushëveprimi përkthimet e dokumentave të Bordeve të IFAC siç janë Guidat, Kodet e Etikës dhe dokumenta e propozime të tjera të publikuara nga IFAC. Shuma më 31 dhjetor 2018 për t'u përdorur në vitet e ardhshme mbetet 649.796 Lekë. Në të ardhura të periudhave të ardhshme janë grupuar edhe disa pagesa të kuotave të kryera më tepër (kuota fikse të AL, kuota të kandidatëve, të kandidatëve për provime AL/KM etj.) që do të konsiderohen për vitin në vijim në shumën 1.155.866 Lekë.

12. Ndryshime në pasurinë neto

Gjatë vitit 2018 pasuria neto e IEKA-s është paksuar me shumën 2,065,211 Lekë.

13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore

Burimet e fondeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi i mbyllur
Përshkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Nga kuota fikse Alve	14,668,323	21,268,663
Nga kuota variabël e Alve	7,303,790	4,347,337
Nga kuota e regjistrimit në praktikën prof.	1,050,000	950,000
Nga kuota e regjistrimit të shoqërive	175,000	35,000
Nga kuota fikse ALve Pasivë	402,400	360,025
Të ardhura të tjera	420,116	971,667
Sponsorizime - Konferenca 20 Vjetori		1,098,812
Totali i Të Ardhurave	24,019,629	29,031,504

13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore (vazhdim)

Në Janar të vitit 2015, me hyrjen në fuqi të ndryshimit të Statutit të IEKA për afatin e deklarimit të misionëve të AL dhe shoqërive (nga 31 mars u vendos në 25 janar) u regjistruan në të ardhurat nga kuota variabël edhe të ardhurat sipas deklarimit të misionëve për vitin 2014.

Të ardhurat nga kuota variabël përfaqësojnë të ardhurat sipas deklarimit të misionëve të ALve për vitin 2018/2017. Kuotat e AL pasivë të arkëtueshme (të pambledhura deri më 31 dhjetor 2018/2017) nuk janë regjistruar në të ardhura meqenëse Drejtimi i Institutit vlerëson si mjaft të vështirë mbledhjen e tyre. Në të ardhurat e periudhës janë përfshirë vetëm kuotat e AL-ve pasivë të arkëtuara. Një pjesë e ALve pasivë ndodhet jashtë Shqipërisë, një pjesë tjetër nuk paguajnë dhe nuk ka një mekanizëm që t'i detyrojë këta AL të kryejnë pagesën gjatë periudhës që janë pasivë.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

14. Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore		
Pagat e punonjësve	4,337,271	4,259,891
Sigurimet shoqërore	554,046	552,719
Të tjera	576,000	780,000
Nën Totali - Pagat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore	5,467,317	5,592,610
 Honorare drejtimi, KKB, Audituesi i PF	4,183,380	4,249,224
Honorare për Autoritetin e Regj. dhe komitete	992,500	860,500
Nën Totali - Drejtimi, Honoraret e Komiteteve	5,175,880	5,109,724
 Shpenzime zhvlerësimi	2,168,801	2,013,218
Kuota regjistrimi në org, Profesionale	2,057,168	2,064,901
Udhëtime e djeta	2,210,529	1,675,866
Telefon, internet	310,782	221,405
Energji, ujë	178,604	167,510
Kancelari	160,262	216,960
shpenzime të tjera	4,405,789	9,610,119
Nën Totali - Shpenzime administrative dhe të tjera	11,491,935	15,969,979
 Totali përdorimeve	22,135,132	26,672,313

Më 31 dhjetor 2018 Instituti ka 5 punonjës me kohë të plotë (31 dhjetor 2017: 4 punonjës me kohë të plotë).

Diferenca midis Burimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 13) dhe Përdorimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 14) është në shumën prej 1,884,499 Lekë (2017: 2,359,191 Lekë).

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

15. Burimet dhe përdorimet e fondeve për kualifikimin e ALve dhe kandidatëve

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Burimet e fondeve nga kualifikimi AL	135,000	182,000
Burimet e fondeve nga kandidatët	1,407,500	1,505,500
Burimet nga trajnimi SKK/SNK	1,060,000	568,000
Totali	2,602,500	2,255,500
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e AL	(1,262,562)	(1,228,496)
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e kandidatëve	(1,249,090)	(1,321,050)
Përdorimet nga trajnimi SKK/SNK	(510,764)	(354,968)
Totali	(3,022,416)	(2,904,514)
Teprica nga kualifikimet për AL dhe kandidatët	(419,916)	(649,014)

16. Burime dhe përdorime nga botimet

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Totali i të ardhurave nga botimet	135,220	11,000
Totali i shpenzimeve të botimeve	(55,019)	(132,517)
Teprica nga Botimet	80,201	(121,517)

Aktiviteti Profesional që mbulohet nga teprica e akumuluar

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Aktivitet prof që mbulohet nga tep. akumul	3,858,829	

17. Teprica / (defiçiti) neto i burimeve të vitit

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017
Teprica e Burimeve		
Teprica nga aktiviteti	1,884,499	2,359,191
Teprica nga kualifikimet	(419,916)	(649,014)
Teprica nga Botimet	80,201	(121,517)
Aktivitet prof që mbulohet nga tep. akumul	(3,858,829)	
Të ardhura financiare	248,836	451,540
Teprica	(2,065,208)	2,040,200

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës 31 dhjetor 2018 e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.